

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

SHËRBIME KARROCERIE

**Niveli III i KSHK
(1 vjeçar)**

**(Në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh
transporti”)**

Kodi: M4-III-23

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2023

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime karrocërie”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime karrocërie”, niveli III i KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shërbime karrocërie”, niveli III i KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime karrocërie”, niveli III i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime karrocërie”, niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Shërbime karrocërie”, niveli III i KSHK

III. Plani mësimor për profilin “Shërbime karrocërie”, niveli III i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime karrocërie”, niveli III i KSHK,

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime karrocierie” (1 vjeçar), niveli III i KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e karrocierisë në mjetet e transportit”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Shërbime karrocierie” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh transporti”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Shërbime karrocërie”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Shërbime karrocërie”, Niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të menaxhojë karrierën profesionale, duke analizuar mundësitë e punësimit, të vetëpunësimit dhe të të mësuarit.
- Të konceptojë planin për hapjen një biznes të vogël, duke kryer një studim fizibiliteti të produktit, planifikimin e prodhimit dhe marketingun për shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit.
- Të zbatojë standardet profesionale që zbatohen në shërbimet e karrocërive të mjeteve të transportit.
- Të interpretojë dhe plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit.
- Të organizojë vendin e punës për kryerjen e shërbimeve të karrocërisë në mjetet e transportit.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e duhura për kryerjen e shërbimeve të karrocërisë në mjetet e transportit.
- Të kryejë kontrollet dhe matjet e nevojshme për shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit.
- Të përdorë dhe mirëmbajë materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet e punës.
- Të përcaktojë proceset e riparimit duke interpretuar informacionin teknik të përfshirë në manuale dhe katalogë, sipas praktikës së mirë profesionale.
- Të lokalizojë dhe diagnostikojë deformimet në strukturat e automjeteve, duke ndjekur procedurat e vendosura dhe praktikën e mirë profesionale.



- Të realizojë diagnostikimin e parregullsive në pjesët e karrocerisë së mjeteve të transportit.
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes në karroceritë e mjeteve të transportit
- Të kryejë zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të karrocerive të mjeteve të transportit.
- Të kryejë punime në elementët që janë pjesë e karrocerisë së mjetit, të montuara me anë të nyjeve të lëvizshme.
- Të kryejë punime në elementët metalikë dhe sintetikë të karrocerisë duke përdorur teknikat dhe procedurat e përcaktuara.
- Të kryejë punime në elementët ose pjesët e karrocerisë të montuara me anë të nyjeve të palëvizshme duke aplikuar teknikat e duhura.
- Të realizojë teknikat e saldimit me ngjitje (saldim me hark elektrik, me gaz, me ngjitje të butë dhe të fortë) të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë;
- Të përgatisë, të mbrojë dhe të lyej sipërfaqet e mjetit duke zbatuar procedurat e përcaktuara.
- Të riparojë deformimet e elementeve strukturore të palëvizshme të karrocerisë duke përdorur pajisjet dhe mekanizmat përkatëse dhe duke aplikuar teknikat e duhura.
- Të rivendosë sigurinë pasive dhe aktive në automjete pas punimeve të kryera
- Të bashkëpunojë me repartin e diagnostikimit elektroauto dhe kompjuterik për kontrollin e mjetit për rastet kur janë bërë çmontime, zëvendësime ose punime elektrike, elektronike ose në sistemin kompjuterik kur janë bërë punime si pasojë e aksidentit ose punime ndihmëse të domosdoshme për riparimin e karrocerisë;
- Të verifikojë rezultatet e ndërhyrjeve të tyre duke i krahasuar me standardet e cilësisë të vendosura nga prodhuesi.
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes në makineri dhe pajisje, në përputhje me fletën e mirëmbajtjes dhe periodicitetin e përcaktuar.
- Të komunikojë me etikën e duhur në kuadrin e veprimtarive profesionale.
- Të përshtaten me punë të ndryshme dhe situata të reja pune të shkaktuara nga ndryshimet teknologjike dhe organizative në proceset e prodhimit.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimeve në karroceritë e mjeteve të transportit.
- Të përdorë mjete digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime karrocerie”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Shërbime karrocerie”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me Certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje/servise të ndryshme që kryejnë shërbime të karrocerive të mjeteve të transportit. Gjithashtu, me përvojë pune të mëtejshme, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e shërbimeve të karrocerisë në mjetet e transportit.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK

Plani mësimor për profilin mësimor “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-18-543-23	Shërbimet e karrocierisë në mjetet e transportit	5
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-18-1927-23	Punime në pjesët e çmontueshme jostrukturore të karrocierisë	34
2	M-18-1928-23	Punime në pjesët e paçmontueshme jostrukturore të karrocierisë	33
3	M-18-1025-23	Punime të saldimit me hark elektrik në karrocieri	33
4	M-18-1026-23	Punime të saldimit me gaz në karrocieri	33
5	M-18-1929-23	Saldime TIG, MIG dhe MAG në karrocieri	69
6	M-18-1027-23	Punime të ngjitjes në karrocieri	34
7	M-18-1930-23	Riparimi i shformimeve të pjesëve metalike të karrocierisë	34
8	M-18-1029-20	Punime të lyerjes së pjesëve metalike të karrocierisë	69
9	M-18-1030-20	Riparimi i aksesorëve në karrocieritë e mjeteve të transportit	69
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-18-1032-20	Punime të lyerjes së pjesëve plastike të karrocierisë	51
2	M-18-1033-20	Zëvendësimi i xhamave të mjeteve të transportit	51
3	M-18-1931-23	Riparimi i strukturës së mjetit me pajisje shtrënguese	51
4	M-18-1932-23	Diagnostikimi elektronik në elementët strukturore të mjetit	51
5	M-18-1581-20	Siguria në punën me automjetet hibride dhe elektrike	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)



IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxëni duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathhtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxëni nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Shërbime karrocierie”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve

dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë dhe të krijojnë kushte për zbatim.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e shërbimeve të karrocierive të automjeteve.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime karrocierie”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Certifikatën profesionale të nivelit dhe Suplementin përkatës për këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 68 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë

Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	4 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë

2. Lënda “Shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit” (L-18-543-23). Kl.12-170 orë

• Synimet e lëndës “Shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë strukturën e automjetit, llojet e karrocërisë, kabinave dhe shasive si dhe karakteristikat e tyre.
- Të përshkruajë elementët e lëvizshëm të jashtëm dhe të brendshëm jo strukturor të automjetit
- Të shpjegojë kuptimin për shërbimet e karrocërisë së mjeteve të transportit.
- Të klasifikojë shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e një servisi për shërbimet e karrocërisë
- Të përshkruajë procesin teknologjik dhe organizimin e punës në shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit.
- Të dallojë veglat, instrumentet dhe pajisjet e punës të një servisi për shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit si dhe për procese pune të ndryshme
- Të listojë proceset e riparimit duke interpretuar informacionin teknik të përfshirë në manuale dhe katalogë, sipas praktikës së mirë profesionale.
- Të përshkruajë deformimet në strukturat e automjeteve, duke ndjekur procedurat e vendosura dhe praktikën e mirë profesionale.
- Të listojë elementët që janë pjesë e trupit të mjetit, të montuara me anë të nyjeve të lëvizshme.
- Të përshkruajë teknikat dhe procedurat e përcaktuara të riparimit në elementët metalikë dhe sintetikë të karrocërisë duke përdorur.
- Të përshkruajë teknikat dhe procedurat e përcaktuara të riparimit në elementët ose pjesët e trupit me anë të nyjeve të fiksuara.
- Të përshkruajë teknikat dhe procedurat e përcaktuara të mbrojtjes dhe të lyerjes së sipërfaqeve të mjetit duke zbatuar procedurat e përcaktuara.
- Të përshkruajë deformimet e elementëve strukturorë të palëvizshëm të trupit duke përdorur pajisjet e kërkuara dhe duke aplikuar teknikat e duhura.



- Të përshkruajë procesin e verifikimit të e rezultateve të ndërhyrjeve të kryera duke i krahasuar me standardet e cilësisë të vendosura nga prodhuesi.
- Të kryej mirëmbajtjen në makineri dhe pajisje, në përputhje me fletën e mirëmbajtjes dhe periodicitetin e përcaktuar.
- Të listojë procedurat e parandalimit të rrezikut në punë dhe mjedis, në përputhje me dispozitat e rregulloreve
- Të përshkruajë mënyrën e përzgjedhjes së aksesorëve dhe pjesëve që do të zëvendësohen në programet elektronike të pjesëve të këmbimit dhe aksesorëve (epc- katalogu elektronik i pjesëve), si dhe kushtet për çmontimin e tyre;
- Të përshkruajë procedurën e çmontimit dhe montimit të pjesëve xhenerike nga strukturat mbajtëse, shasitë, karrocëritë dhe kabinat e automjeteve;
- Të përshkruajë procedurën e çmontimit dhe montimit të mekanizmave të fshirëseve të xhamave, të bravave të dyerve, mekanizmit të komandimit të xhamave të dyerve, mekanizmin e pasqyrave anësore,
- Të përshkruajë llojet e saldimeve të përdorura në automjete: MIG-MAG, pika elektrike, TIG, MIG-Brazing, sinergjike për aluminin, elektrike me elektrodë të veshur, oksiacetileni
- Të listojë pajisjet e saldimit të përdorura: karakteristikat, funksioni, funksionimi, parametrat e rregullimit në procese.
- Të listojë materialet mbushëse të përdorura në saldime të ndryshme. Gazrat dhe deoksiduesit.
- Të listojë teknikat e saldimit. Elementet mbrojtëse të pajisjeve të saldimit, sipas dokumentacionin teknik të automjetit.
- Të përshkruajë trajtimet antikoroze: Fenomeni i korrozionit. Korrozioni në materialet metalike.
- Të përshkruajë teknikat e riparimit e mbrojtjes nga korrozioni, veglat, instrumentet dhe pajisjet e punës dhe verifikimi i riparimit të kryer, sipas dokumentacionin teknik të automjetit..
- Të listojë ngjitësit strukturorë, materialet ngjitëse (pasta epokside, rrëshira sintetike etj.).
- Të listojë parregullsitë e aksesorëve të karrocërisë (bravat, dorezat, menteshat, mekanizmat e xhamave, antenat, fshirëset e xhamave, mbajtëset e pasqyrave etj.);
- Të përshkruajë procesin teknologjik të riparimit të aksesorëve kryesorë të karrocërisë dhe kabinave
- Të përshkruajë procedurat e punimeve në sistemet e sigurisë pasive, sipas dokumentacionin teknik të automjetit.
- Të përshkruajë procesin teknologjik për të realizuar lyerjen/ stukimin e pjesëve metalike e plastike të karrocërisë;
- Të përshkruajë teknikat e lyerjes së sipërfaqeve metalike e plastike të karrocërisë;
- Të përshkruajë procesin e pjekjes së sipërfaqeve metalike e plastike të lyera;
- Të përshkruajë teknikën e luçidimit të sipërfaqeve metalike të karrocërisë, të lyera dhe të pjekura.
- Të përshkruajë proceset e kontrollit përfundimtar për sipërfaqet e lyera, pjekura dhe luçiduara të karrocërisë.
- Të përshkruajë dokumentacionin teknik të automjetit në shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit, për procedurën e çmontimit dhe montimit e strukturave mbajtëse, shasive, karrocërive dhe kabinave të automjeteve;
- Të tregojë cilat janë matjet dhe kontrollet kryesore të elementeve të karrocërisë
- Të përshkruajë mënyrën e përcaktimit të shkallës së dëmtimit të pjesëve të karrocërisë (e mesme, e lehtë, e rëndë, si dhe e pjesshme dhe e plotë);



- Të përshkruajë mënyrën e shpërndarjes së forcave goditëse në strukturat mbajtëse, shasitë, karrocëritë dhe kabinat e automjeteve;
- Të përshkruajë rëndësinë e konsultimit me instruksionet e prodhuesit për matjen e shformimeve dhe për riparimin e karrocërisë;
- Të përshkruajë teknikat e riparimit me “spoter” (me njolla tërheqje nëpërmjet ngjitjes me pikim);
- Të përshkruajë teknika e riparimit të pjesëve me shformim të karrocërisë/shasi, me anë të pajisjeve speciale, si kalibrat (bangot universale të drejtimit të shasisë etj.);
- Të përshkruajë teknikat e riparimit të pjesëve të shformuara nëpërmjet tërheqjes me presa hidraulike;
- Të përshkruajë diagnozën elektronike (me kompjuter) të trupit të automjetit;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit”, kl. 12 - 170 orë:**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për strukturën e automjetit, llojet e karrocërisë dhe shasive si dhe karakteristikat e tyre.	2 orë
Tema 2	Elementët e palëvizshëm strukturor të automjetit	2 orë
Tema 3	Elementët e lëvizshëm të jashtëm dhe të brendshëm jo strukturor të automjetit	4 orë
Tema 4	Llojet dhe mënyrat e lidhjeve dhe bashkimeve të elementëve dhe nyjeve të karrocërisë	2 orë
Tema 5	Procedurat, teknikat e bashkimit dhe elementët e përdorur në karrocëritë dhe shasitë e automjeteve	4 orë
Tema 6	Materialet metalike të përdorura në automjete	3 orë
Tema 7	Ndryshimi i vetive të materialeve metalike nëpërmjet trajtimeve termike	3 orë
Tema 8	Materialet plastike dhe kompozite të përdorura në karrocëritë e mjeteve të transportit	2 orë
Tema 9	Përbërja dhe karakteristikat e materialeve plastike, sjellja e materialit ndaj ngrohjes	2 orë
Tema 10	Klasifikimi dhe veçoritë e shërbimeve të karrocërisë në mjetet e transportit	4 orë
Tema 11	Ndërtimi dhe funksionimi i një servisi për shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit	4 orë
Tema 12	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit	4 orë
Tema 13	Procesi teknologjik dhe organizimi i punës në shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit.	2 orë
Tema 14	Përzgjedhja e aksesorëve dhe pjesëve që do të zëvendësohen në programet elektronike të pjesëve të këmbimit dhe aksesorëve (EPC- Katalogu Elektronik i Pjesëve), në shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit.	5 orë
Tema 15	Llojet e deformimeve të elementëve metalike të lëvizshëm dhe shkaqet e tyre.	3 orë
Tema 16	Teknikat e riparimit të elementëve metalike të lëvizshëm, veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse, si dhe kontrolli i riparimit të kryer, sipas dokumentacionit teknik të automjetit	6 orë
Tema 17	Llojet e deformimeve të elementëve plastike dhe kompozite të lëvizshëm, dhe shkaqet e tyre.	4 orë
Tema 18	Teknikat e riparimit të elementëve plastike dhe kompozite të lëvizshëm,	4 orë



	veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse, si dhe kontrolli i riparimit të kryer	
Tema 19	Llojet e dëmtimeve të elementëve të palëvizshëm të karrocërisë dhe shasisë, si dhe shkaqet e tyre.	4 orë
Tema 20	Teknikat e riparimit të elementëve të palëvizshëm të karrocërisë, veglat, pajisjet e punës, instrumentet matëse, si dhe kontrolli i riparimit të kryer, sipas dokumentacionin teknik të automjetit	4 orë
Tema 21	Llojet e saldimeve, veçoritë dhe përdorimi i tyre në punimet e karrocërisë së mjeteve të transportit	6 orë
Tema 22	Pajisjet e saldimit që përdoren në shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit. Karakteristikat, funksioni i tyre.	4 orë
Tema 23	Materialet mbushëse në saldime. Gazrat dhe deoksiduesit.	3 orë
Tema 24	Teknikat e saldimit me hark elektrik dhe me gaz, veçoritë dhe përdorimi i tyre në shërbimet e karrocërisë	4 orë
Tema 25	Shembuj të riparimit të elementeve të karrocërisë me anë të saldimit me hark elektrik dhe me gaz.	4 orë
Tema 26	Teknikat e saldimit TIG/ MIG/ MAG veçoritë dhe përdorimi në shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit.	4 orë
Tema 27	Shembuj të riparimit të elementeve të karrocërisë me anë të saldimit TIG/ MIG/ MAG	4 orë
Tema 28	Llojet e prerjeve, bashkimeve dhe lidhjeve në punimet e karrocërisë së mjeteve të transportit. Veçoritë dhe përdorimi i tyre	4 orë
Tema 29	Shembuj të riparimit të elementeve të karrocërisë me prerje, bashkime dhe lidhje	4 orë
Tema 30	Fenomeni i korrozionit në materialet metalike. Teknikat e riparimit për mbrojtjen nga korrozioni. Trajtimi i tij në shërbimet e korrocërisë	4 orë
Tema 31	Teknikat e riparimit me ngjitje plastike (pasta epokside, rrëshira sintetike, elektroda plastike, etj.). Veçoritë dhe përdorimi i tyre në shërbimet e karrocërisë në mjetet e transportit.	4 orë
Tema 32	Shembuj të riparimit të elementeve të karrocërisë me ngjitje plastike (pasta epokside, rrëshira sintetike, elektroda plastike, etj.).	4 orë
Tema 33	Xhamat e automjeteve, menyrat e zëvendësimit të tyre.	4 orë
Tema 34	Njohuri të përgjithshme për lyerjen dhe luçidimin e sipërfaqeve të ndryshme të karrocërisë.	6 orë
Tema 35	Procesi teknologjik i stukimit, lyerjes, pjekjes dhe luçidimit të sipërfaqeve të karrocërisë.	6 orë
Tema 36	Aksesorët e karrocërisë dhe të kabinës (bravat, dorezat, fshirëset e xhamave, mbajtëset e pasqyrave etj.), ndërtimi dhe parregullsitë e tyre.	6 orë
Tema 37	Teknikat e riparimit të aksesorë të kabinës dhe karrocërisë.	6 orë
Tema 38	Njohuri për elementët e çmontueshëm të kabinës (dyer, parafango, parakolp, prapakolp etj.), punimet që kryhen ne to.	5 orë
Tema 39	Njohuri për elementët e pjesës së brendshme të kabinës (AIRBAG, kroskot, ndenjësë, rripa sigurimi etj.) dhe punimet që kryhen ne to.	5 orë
Tema 40	Metodat dhe pajisjet e kontrollit të shkallës së dëmtimit të karrocërisë. Veçortë dhe përdorimi i tyre.	5 orë
Tema 41	Teknologji për eliminimin e deformimeve të karrocërisë veglat, instrumentet dhe pajisjet e punës.	5 orë
Tema 42	Teknikat e kontrollit dhe të zëvendësimit të shasisë.	5 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli: “Punime në pjesët e çmontueshme jostrukturore të karrocerisë”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Profili: Shërbime karrocerise

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NË PJESËT E ÇMONTUESHME JOSTRUKTURE TË KARROCERISË	(M-18-1927-23)
-------------------------	--	-----------------------

Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer zmontimin dhe montimin e elementëve të çmontueshëm, jostruktural të karrocerisë.
Kohëzgjatja e modulit	34 orë mësimore
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.

Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi zmonton pjesët e lëvizëshme (aksesorë dhe elementë estetik) të lidhur me bulona, vida, kapëse dhe me thumba.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë dokumentacionit teknik të automjetit;- të analizojë përbërjen e karrocerisë, duke përcaktuar funksionin e elementëve jo-strukturorë të lëvizshëm;- të përcaktojë metodat për zmontimin e aksesorëve dhe elementëve estetik;- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zmontim;- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për zmontim elementët të çmontueshëm të lidhur me bulona;- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për zmontim elementët të çmontueshëm të lidhur me vida;- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për zmontim elementët të çmontueshëm të lidhur me kapëse;- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për zmontim elementët të çmontueshëm të lidhur me thumba;- të zbatojë procedurat e zmontimit për aksesorët dhe elementëve estetik;- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zmontimin e elementët të çmontueshëm (aksesorë dhe elementë estetik);- të zmontojë duke zbatuar procedurat dyert;- të zmontojë duke zbatuar procedurat mbulesën e motorit
--	---

-
- (kofanos);
- të zmontojë duke zbatuar procedurat kapakun e bagazhit;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat mbulesën e motorit (kofanos);
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat parakolpot;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat parafangot.
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat maskarinon;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat ndenjëset;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat kroskotin;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat veshjet e brendëshme të kabinës;
 - të zmontojë rripat e sigurimit, duke zbatuar procedurat;
 - të zmontojë gominat izoluese duke zbatuar procedurat;
 - të zmontojë baxhanë duke zbatuar procedurat;
 - të zmontojë airbag-un duke zbatuar procedurat;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat aksesorët.
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjes që pengojnë në riparimet e karrocërisë;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat elementët e sistemit të drejtimit që pengojnë në riparimet e karrocërisë;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat elementët e sistemit të ftohjes që pengojnë në riparimet e karrocërisë;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat elementët e sistemit të ajrit të kondicionuar që pengojnë në riparimet e karrocërisë;
 - të zmontojë, duke zbatuar procedurat, elementët e sistemit të sistemit të furnizimit përzirje ajër lëndë djegëse që pengojnë në riparimet e karrocërisë;
 - të zmontojë, duke zbatuar procedurat, elementët e sistemit të shkarkimit të garave që pengojnë në riparimet e karrocërisë;
 - të zmontojë duke zbatuar procedurat elementët e transmisionit të fuqisë që pengojnë në riparimet e karrocërisë;
 - të zmontojë, duke zbatuar procedurat, elementët e sistemit të frenimit që pengojnë në riparimet e karrocërisë;
 - të zmontojë, duke zbatuar procedurat, grupet optike të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit;
 - të zmontojë pasqyrat duke zbatuar procedurat;
 - të zmontojë mekanizmin e ngritjes së xhamave. duke zbatuar procedurat;
 - të zmontojë sistemin e fshirjes së xhamit duke zbatuar procedurat;
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit, gjatë zmontimit të elementëve jo-strukturorë të çmontueshëm.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.



RN 2 Nxënësi monton pjesët e çmontueshme (aksesorë dhe elementë estetik) të lidhur me bulona, vida, kapëse dhe me thumba.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionit teknik të automjetit;
- të analizojë përbërjen e karrocërisë, duke përcaktuar funksionin e elementëve jo-strukturorë të çmontueshëm;
- të përcaktojë metodat për montimin e aksesorëve dhe elementëve estetik;
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për montim;
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për montimin e elementëve të çmontueshëm të lidhur me bulona;
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për montimin elementëve të çmontueshëm të lidhur me vida;
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për montimin e elementëve të çmontueshëm të lidhur me kapëse;
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për montimin e elementëve të çmontueshëm të lidhur me thumba;
- të zbatojë procedurat e montimit për aksesorët dhe elementëve estetik;
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për montimin e elementëve të çmontueshëm (aksesorë dhe elementë estetik).
- të pozicionojë elementin që do të montohet në mënyrë korrekte, për fiksimin e mëvonshëm të tij;
- të aplikojë moment rrotullues shtrëngues të nevojshëm në lidhjet me bulona;
- të vendosë fermot bllokuese të nevojshëm në lidhjet me vida;
- të vendosë kapëset e bashkimit me mjetet e nevojshme
- të montojë duke zbatuar procedurat dyert;
- të montojë duke zbatuar procedurat mbulesën e motorit (kofanos);
- të montojë duke zbatuar procedurat kapakun e bagazhit.
- të montojë duke zbatuar procedurat mbulesën e motorit (kofanos);
- të montojë parakolpot duke zbatuar procedurat;
- të montojë parafangot duke zbatuar procedurat;
- të montojë maskarinon duke zbatuar procedurat;
- të montojë ndenjëset duke zbatuar procedurat;
- të montojë kroskotin duke zbatuar procedurat;
- të montojë veshjet e brendëshme të kabinës, duke zbatuar procedurat;
- të montojë rripat e sigurimit duke zbatuar procedurat;
- të montojë gominat izoluese duke zbatuar procedurat;
- të montojë baxhanë duke zbatuar procedurat;
- të montojë airbag-un, duke zbatuar procedurat;
- të montojë aksesorët, duke zbatuar procedurat;
- të montojë elementët e sistemit të shuarjes së lëkundjes që pengojnë në riparimet e karrocërisë, duke zbatuar

- procedurat;
- të montojë elementët e sistemit të drejtimit që pengojnë në riparimet e karrocerisë, duke zbatuar procedurat;
 - të montojë elementët e sistemit të ftohjes që pengojnë në riparimet e karrocerisë, duke zbatuar procedurat;
 - të montojë, duke zbatuar procedurat, elementët e sistemit të ajrit të kondicionuar që pengojnë në riparimet e karrocerisë;
 - të montojë, duke zbatuar procedurat, elementët e sistemit të sistemit të furnizimit përzirje ajër lëndë djegëse që pengojnë në riparimet e karrocerisë;
 - të montojë, duke zbatuar procedurat, elementët e sistemit të shkarkimit të garave që pengojnë në riparimet e karrocerisë;
 - të montojë, duke zbatuar procedurat, elementët e transmisionit të fuqisë që pengojnë në riparimet e karrocerisë;
 - të zmontojë, duke zbatuar procedurat, elementët e sistemit të frenimit që pengojnë në riparimet e karrocerisë;
 - të kryejë rregullime dhe kontrole të thjeshta në elementët e sistemeve, që pengojnë në riparimet e karrocerisë;
 - të montojë grupet optike të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit, duke zbatuar procedurat;
 - të kryejë rregullime të grupeve optike të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit;
 - të kontrollojë grupet optike të sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit;
 - të montojë pasqyrat, duke zbatuar procedurat;
 - të montojë mekanizmin e ngritjes së xhamave duke zbatuar procedurat;
 - të montojë sistemin e fshirjes së xhamit, duke zbatuar procedurat;
 - të verifikojë funksionueshmërinë përfundimtare të elementit të montuar;
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të elementëve jo-strukturorë të çmontueshëm.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime zmontimit dhe montimit të elementëve të çmontueshëm jostruktural të karrocerisë.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të zmontimit dhe montimit të elementëve të çmontueshëm jostruktural të karrocerisë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të zmontimit dhe montimit të elementëve të çmontueshëm jostruktural të karrocerisë së automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të



pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të zmontimit dhe montimit të elementëve të çmontueshëm, jostruktural të karrocërisë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së zmontimit dhe montimit të të elementëve të çmontueshëm jostruktural të karrocërisë së automjeteve.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për zmontimin dhe montimin e të elementëve të çmontueshëm jostruktural të karrocërisë së automjeteve.
 - Automjete mësimore.
 - Elementë të çmontueshëm jostruktural të karrocërive të automjeteve.
 - Kataloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli: “Punime në pjesët e paçmontueshme jostrukturore të karrocerisë”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Profili: Shërbime karrocerise

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NË PJESËT E PAÇMONTUESHME JOSTRUKTURE TË KARROCERISË	(M-18-1928-23)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të elementëve të ndryshme- të paçmontueshëm të karrocerisë.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zgjedh metodat dhe pajisjet e duhura në varësi të llojit të bashkimit që duhet të priset dhe zëvendësimit të pjesëve të lidhura. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të analizojë dokumentacionit teknik të automjetit.- të analizojë proceset e ndarjes së elementëve të ndryshëm paçmontueshëm, duke zgjedhur metodat dhe pajisjet e duhura.- të përzgjedhë procedurat për ndarjen e elementeve metalikë sipas mënyrës së bashkimit të përdorur.- të përzgjedhë makineritë dhe veglat e ndryshme të përdorura për të hequr bojrat dhe pikat e saldimit.- të përzgjedhë makineritë e ndryshme të përdorura në operacionet e prerjes në fletë metalike.- të përzgjedhë skajin e daltës për procesin e ndarjes.- të përzgjedhë llojin e sharrës që nevojitet në ndarje.- të përzgjedhë metodën e prerjes manuale ose pneumatike të nevojshme për çdo riparim.- të përzgjedhë llojet e ndryshme të teheve për prerësit.- të përcaktojë madhësinë e zëvendësimit, pjesë ose elementë të plotë, ose me seksione të pjesshme.- të analizojë proceset e zëvendësimit të pjesëve, elementeve të plota ose me seksione të pjesshme.- të identifikojë elementin që do të zëvendësohet,- të përcaktojë llojin e lidhjes së përdorur.- të përzgjedhë metodën e riparimit.- të përzgjedhë pajisjet më të përshtatshme të prerjes.- të analizojë paraqitjen e prerjes që lejon ekzekutimin e saj	

sipas specifikimeve teknike.

- të përzgjedhë metodën e prerjes, duke zgjedhur pajisjet më të përshtatshme të prerjes.
- të përzgjedhë mjetet e duhura antikoroze për çdo riparim.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përzgjedhjes së metodave dhe pajisjeve të duhura në varësi të llojit të bashkimit që duhet të priset dhe zëvendësin të pjesëve të lidhura.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi realizon punime për zmontimin e ndarjen e elementeve fiks, si dhe për zëvendësimin e pjesëve të lidhura.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të automjetit.
- të përgatitë zonën për çmontimin dhe ndarjen e elementeve të paçmontueshëm
- të zbatojë procedurat e ndryshme që duhen kryer në përgatitjen e elementeve të paçmontueshme;
- të zbatojë procedurat për eliminimin e bojërave, ngjitësve dhe materialeve kundër ndryshkut;
- të zbatojë procedura për heqjen e pikave të saldimit me makineri frezuese dhe shpuese;
- të zbatojë procedura për lëvizjen e paneleve;
- të kryejë preceset e shpimit dhe frezimit të pikave të saldimit.
- të kryejë preceset e heqjes së pikave të saldimit me daltë pneumatike dhe manuale.
- të zmontojë dhe ndajë duke zbatuar procedurat elementët të paçmontueshëm, duke përdorur saktë pajisjet dhe veglat.
- të kryejë operacionet e ndryshme që do të kryhen në zmontimin e elementeve të paçmontueshëm:
- të përcaktojë zonën e prerjes sipas standardeve specifike të prodhuesit.
- të kryejë prerje me pajisje të ndryshme (sharrë alternative, rrethore).
- të zmontojë duke zbatuar procedurat panelet (fiks) e paçmontueshme që do të ndërrohen
- të përgatisë pjesët e reja që do të ndërrohen.
- të verifikojë që punimet e prerjes së kryer janë në përputhje me specifikimet e dhëna në standardet teknike.
- të llogaritë koston dhe çmimin e punime për zmontimin e ndarjen e elementeve të paçmontueshëm dhe për zëvendësimin e pjesëve të lidhura.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punime për zmontimin e ndarjen e elementeve të

paçmontueshme dhe për zëvendësimin e pjesëve të lidhura.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi bashkon dhe lidh elementet e paçmontueshëm jostrukturorë.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të automjetit.
- të përgatit bashkimin dhe lidhjen e nyjeve në elementë e paçmontueshëm jo strukturorë.
- të përgatit fugat për të aplikuar saldimit në vend
- të pastrojë zonat e bashkimit dhe lidhjes, duke eliminuar mbetjet ekzistuese.
- të përgatisë zonat e mbivendosjes.
- të fiksojë zonën e mbivendosjes me pincë me fileto.
- të aplikojë mastikët ose praimerët antioksidues në zonat e lidhjes.
- të aplikojë përforcimet në rastet kur konsiderohen të nevojshme, për të mbështetur pjesët që do të bashkohen.
- të vendosë pjesët sipas dimensioneve të dhëna nga prodhuesi, duke kontrolluar shtrirjen e elementëve të zëvendësuar me pjesët ngjitur.
- të verifikojë që zëvendësimi i pjesëve plotëson specifikimet teknike në lidhje me metodat e montimit dhe mbrojtjen kundër korrozionit.
- të bashkojë duke zbatuar procedurat elementet të paçmontueshme jo strukturore.
- të bashkojë elementet duke përdorur llojet e saldimit të përdorura në sistemet e bashkimit të fiksuar.
- të saldojë duke përdorur teknikat me pikë dhe të vazhdueshëm.
- të kryejë saldimit të butë.
- të kontrollojë që saldimit e marra plotësojnë specifikimet e një saldimit standard (rezistenca, shkrirja e skajeve...).
- të verifikojë që elementët e salduar të kthejnë karakteristikat funksionale të specifikuara nga prodhuesi dhe/ose nevojat e kërkuara.
- të rregullojë zonën e bashkuar duke përdorur mjetet e nevojshme.
- të kryejë heqjen e gërvishtjeve me një fresibë elektrik me disqe heqëse dhe gërryerje të ulët.
- të kontrollojë që zonat e bashkuara të plotësojnë specifikimet teknike për nga trashësia e fletës.
- të aplikojë mbrojtjen e nevojshme antikorozive në të dy anët e fletëve të bashkuara.
- të rregullojë që zonat e bashkuara të jenë në përputhje me mbrojtjen e nevojshme antikorozive.
- të verifikojë që punimet e kryera janë në përputhje me specifikimet e dhëna në standardet teknike.

- të llogaritë koston dhe çmimin e punime për bashkimin dhe lidhjen e elementëve të paçmontueshëm jo strukturorë.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punime për bashkimin dhe lidhjen e elementëve të paçmontueshëm jo strukturorë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime punime për bashkimin dhe lidhjen e elementëve të paçmontueshëm jo strukturorë të karrocereve të automjeteve.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punime për bashkimin dhe lidhjen e elementëve të paçmontueshëm jo strukturorë të karrocereve të automjeteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të punime për bashkimin dhe lidhjen e elementëve të paçmontueshëm jo strukturorë të karrocereve të automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për bashkimin dhe lidhjen e elementëve të paçmontueshëm jo strukturorë të karrocereve të automjeteve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së punimeve të elementëve të ndryshme të paçmontueshëm të karrocereve të automjeteve.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për punime të elementëve të ndryshme të paçmontueshëm të karrocereve.
 - Automjete mësimore.
 - Pjesë të karrocereve të automjeteve.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli: “Punime të saldimit me hark elektrik në karroceri”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Profili: Shërbime karrocerie

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË SALDIMIT ME HARK ELEKTRIK NË KARROCERI	(M-18-1025-23)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të parapërgatitur saldimit me hark elektrik të pjesëve të dëmtuara të karrocereve të mjeteve të transportit, si dhe për të kryer riparimin me anë të saldimit me hark elektrik të këtyre pjesëve.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi parapërgatit saldimit me hark elektrik të pjesëve të dëmtuara të karrocereve.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të bëjë analizën dokumentacionit teknik të karrocereve;- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese;- të bëjë kontrollin e pjesës së dëmtuar të karrocereve dhe të përcaktojë shkallën e dëmtimit;- të zmontojë pjesën e dëmtuar të karrocereve (nëse është e nevojshme);- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me saldimit me hark elektrik të pjesës së dëmtuar;- të përzgjedhë aparatet e saldimit me hark elektrik;- të përzgjedhë veglat e nevojshme për të kryer procesin e riparimit me saldimit me hark elektrik.- të përzgjedhë elektrodën e duhura për saldimit;- të veshë uniformën dhe të përdorë mjetet mbrojtëse për saldimit me hark elektrik;- të përgatitë aparatet për saldimit me hark elektrik dhe të përcaktojë regjimin e duhur të saldimit;- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës ;- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për saldimit me hark elektrik. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi saldon me hark elektrik pjesët e dëmtuara të karrocerisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë përgatitjen e bangos dhe vendosjen e pjesë për saldimin me hark elektrik në bango (nëse saldimi do të kryhet në bango);
- të zbatojë teknikat e saldimit me hark elektrik të pjesëve të thyera të karrocerisë (drejtimin e copave të thyera, përgatitjen e buzëve për saldim, realizimin e tegelit të saldimit, punimin përfundimtar të tegelit);
- të zbatojë teknikat e saldimit me hark elektrik të pjesëve të plasaritura të karrocerisë (drejtimin e copës së deformuar, përgatitjen e zonës së plasaritur, realizimin e tegelit të saldimit, punimin përfundimtare të tegelit);
- të zbatojë teknikat saldimit me hark elektrik të pjesëve të dëmtuara prej llamarine (drejtimin e pjesëve të deformuara, përgatitjen e zonës së dëmtuar, realizimin e tegelit të saldimit, punimin përfundimtar të tegelit);
- të kryejë matjen dhe kontrollin e cilësisë së saldimit;
- të bëjë heqjen e pjesës së riparuar nga bangoja (kur saldimi kryhet në bango);
- të kryejë montimin e pjesës së riparuar në karroceri (kur është çmontuar më parë);
- të llogaritë koston dhe çmimin e riparimit me saldim me hark elektrik të pjesës së dëmtuar të karrocerisë;
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit me hark elektrik të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart saldimi ose në mjedis pune ku kryhen punime të riparimit me anë të saldimit me hark elektrik të pjesëve të karrocerive të mjeteve të transportit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të saldimit me hark elektrik të pjesëve të karrocerive.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të parapërgatitjes dhe të realizimit të saldimit me hark elektrik të pjesëve të ndryshme të karrocerive, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e teknikave të duhura të saldimit me hark elektrik të pjesëve të

karrocerive.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së saldimit me hark elektrik.
 - Aparate saldimit me hark elektrik.
 - Materialet e nevojshme për saldimit me hark elektrik të pjesëve të karrocerive.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe saldime me hark elektrik.
 - Karroceri të ndryshme të mjeteve të transportit dhe pjesë të ndryshme të karrocerive.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Kataloge të mjeteve të transportit, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli: “Punime të saldimit me gaz në karroceri”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Profili: Shërbime karrocerie

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË SALDIMIT ME GAZ NË KARROCERI	(M-18-1026-23)
-------------------------	---	-----------------------

Qëllimi i modulit Një modul që aftëson nxënësit për parapërgatitur saldimit me gaz të pjesëve të dëmtuara të karrocereve të mjeteve të transportit, si dhe për të kryer riparimin me anë të saldimit me gaz të këtyre pjesëve.

Kohëzgjatja e modulit 33 orë mësimore

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.

Rezultatet e nxënësve (RN) dhe procedurat e vlerësimit

RN 1 Nxënësi parapërgatit saldimit me gaz të pjesëve të dëmtuara të karrocereve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizën e dokumentacionit teknik të karrocereve;
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese;
- të kryejë kontrollin e pjesës së dëmtuar të karrocereve dhe të përcaktojë shkallën e dëmtimit;
- të zmontojë pjesën e dëmtuar të karrocereve (nëse është e nevojshme);
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me saldimit me gaz të pjesës së dëmtuar;
- të përzgjedhë aparatet e saldimit me gaz;
- të përzgjedhë veglat e nevojshme për të kryer procesin e riparimit me saldimit me gaz;
- të përzgjedhë kanelën e duhur dhe t’u vendosë atë;
- të përzgjedhë elektrodën mbushëse të duhur për saldimit me gaz;
- të veshë uniformën dhe të përdorë mjetet mbrojtëse për saldimit me gaz;
- të përgatitë aparatet për saldimit me gaz dhe të përcaktojë regjimin e duhur të saldimit;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës ;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për saldimit me gaz.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen saldimin me gaz të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë bangon dhe të vendosë në të pjesët për saldimin me gaz (nëse saldimi do të kryhet në bango);
- të zbatojë teknikat e saldimit me gaz të pjesëve të thyera të karrocerisë (drejtimin e copave të thyera, përgatitjen e buzëve për saldimme gaz, realizimin e tegelit të saldimit, punimin përfundimtar të tegelit);
- të zbatojë teknikat e saldimit me gaz të pjesëve të plasaritura të karrocerisë (drejtimin e copës së deformuar, përgatitjen e zonës së plasarit, realizimin e tegelit të saldimit me gaz, punimin përfundimtar të tegelit);
- të zbatojë teknikat e saldimit me gaz të pjesëve të dëmtuara prej llamarine (drejtimin e pjesëve të deformuara, përgatitjen e zonës së dëmtuar, realizimin e tegelit të saldimit me gaz, punimin përfundimtar të tegelit);
- të kryejë matjen dhe kontrollin e cilësisë së saldimit me gaz.
- të bëjë heqjen e pjesës së riparuar nga bangoja (kur saldimi kryhet në bango);
- të kryejë montimin e pjesës së riparuar në karroceri (kur është çmontuar më parë);
- të llogaritë koston dhe çmimin e riparimit me saldim me gaz të pjesës së dëmtuar të karrocerisë;
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit me gaz të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart saldimi me gaz ose në mjedise pune ku kryhen punime të riparimit me anë të saldimit me gaz të pjesëve të karrocerive të mjeteve të transportit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të saldimit me gaz të pjesëve të karrocerive.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të parapërgatitjes dhe të realizimit të saldimit me gaz të pjesëve të ndryshme të karrocerive, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e teknikave të duhura të saldimit me gaz të pjesëve të karrocerive.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së saldimit me gaz.
 - Aparate saldimi me gaz dhe pajisjet përkatëse.
 - Materialet e nevojshme për saldim me gaz të pjesëve të karrocive.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe saldime me gaz.
 - Karroceri të ndryshme të mjeteve të transportit dhe pjesë të ndryshme të karrocive.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katalogë të mjeteve të transportit, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Saldime TIG, MIG dhe MAG në karroceri”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti
Profili: Shërbime karrocerie
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SALDIME TIG, MIG DHE MAG NË KARROCERI	(M-18-1929-23)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të parapërgatitur punime të saldimeve TIG, MIG dhe MAG, të pjesëve të dëmtuara të karrocereve të mjeteve të transportit, si dhe për të kryer riparimin e këtyre pjesëve me këto lloj saldimesh speciale.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi parapërgatit saldimin TIG, MIG, MAG të pjesëve të dëmtuara të karrocereve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të bëjë analizën dokumentacionit teknik të karrocereve.- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese.- të bëjë kontrollin e pjesës së dëmtuar të karrocereve dhe të përcaktojë drejt llojin e materialit dhe shkallën e dëmtimit.- të zmontojë pjesën e dëmtuar të karrocereve (nëse është e nevojshme).- të përcaktojë drejt llojin e saldimit special (TIG-<i>Tungsten Inert Gaz</i>; MIG-<i>Metal Inert Gaz</i> dhe MAG-<i>Metal Active Gaz</i>) që do të përdoret.- të përzgjedhë aparatet e duhura për saldimin special përkatës.- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me saldimin special të pjesës së dëmtuar të karrocereve.- të përzgjedhë veglat e duhura për të kryer procesin e riparimit me saldimin special të përzgjedhur.- të përzgjedhë materialin e duhur mbushës për saldimin special të përzgjedhur.- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për saldimin special.- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për saldime speciale të	

pjesëve të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen saldime TIG, MIG, MAG të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë përgatitjen paraprake të pjesëve të karrocerisë që do riparohen me saldime (TIG, MIG, MAG) (drejtimin e copave të thyera dhe të shformuara, përgatitja dhe pastrimi i buzëve, përgatitja e zonave të plasaritura).
- të përgatitë bangon dhe të vendosë pjesën në bango (nëse saldimi do të kryhet në bango).
- të përgatitë për punë aparatit e përzgjedhur për saldimin special (TIG, MIG ose MAG).
- të vendosë regjimin e saldimit special përkatës.
- të zbatojë teknikat e saldimit special TIG të pjesëve të karrocerisë.
- të zbatojë teknikat e saldimit special MIG të pjesëve të karrocerisë
- të zbatojë teknikat e saldimit special MAG të pjesëve të karrocerisë.
- të kryejë punimin përfundimtar të tegelit të saldimit special të kryer.
- të kryejë matjen dhe kontrollin e cilësisë së saldimit special të kryer.
- të bëjë heqjen e pjesës së riparuar nga bangoja (kur saldimi special kryhet në bango).
- të bëjë montimin e pjesës së riparuar në karroceri (kur është çmontuar më parë).
- të llogaritë koston dhe çmimin e riparimit me saldim special të pjesës së dëmtuar të karrocerisë.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit special të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart saldimi ose në mjedisë pune (servise) ku kryhen punime të riparimit me anë të saldimeve speciale të pjesëve të karrocerive të mjeteve të transportit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të saldimeve speciale të pjesëve të karrocerive.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të parapërgatitjes dhe të realizimit të

saldimeve speciale (TIG, MIG dhe MAG) të pjesëve të ndryshme të karrocive, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e teknikave të duhura të saldimeve speciale të pjesëve të karrocive.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së saldimit në shkollë ose në servise.
 - Aparate për saldime speciale (TIG, MIG dhe MAG) dhe pajisjet përkatëse.
 - Materialet e nevojshme për saldime speciale të pjesëve të karrocive.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrolle dhe saldime speciale.
 - Karroceri të ndryshme të mjeteve të transportit dhe pjesë të ndryshme të karrocive.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katalloge të mjeteve të transportit, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

6. Moduli “Punime të ngjitjes në karroceri”

Drejtimi: Shërbime mjetesesh transporti
Profili: Shërbime karrocerie
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË NGJITJES NË KARROCERI	(M-18-1027-23)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të të zëvendësimit, bashkimit dhe riparimit, të pjesëve metalike dhe plastike të karrocërisë me anë të ngjitjeve të buta dhe të forta, me saldim plastik dhe me anë të bashkimeve me materiale ngjitëse.	
Kohëzgjatja e modulit	34 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN1	Nxënësi zmonton dhe monton elementët e çmontueshëm, të lidhur me materialet ngjitëse (pasta epokside, rrëshira sintetike, etj.). Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocërisë.- të përcaktojë karakteristikat dhe përdorimi i nyjeve të lidhur me materialet ngjitëse.- të analizojë specifikimet teknike të elementëve të lidhur me materialet ngjitëse.- të përcaktojë procedurat e zmontimit për elementët e lidhur me materialet ngjitëse.- të përgatisë zonën e bashkimit.- të përzgjedhë produktet e përdorura për procesin e ngjitjes.- të përzgjedhë llojin e ngjitësit.- të përzgjedhë katalizatorët, reagentët dhe pastruesit- të përzgjedhë përshpejtuesit dhe mastikët.- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e duhura për ngjitjen.- të pastrojë pjesët dhe zonat e bashkimit tërësisht.- të përzierje produktet për bashkimin e elementeve të ngjitur, në përputhje me specifikimet e prodhuesit.- të aplikojë sasi të barabarta ngurtësues dhe rrëshirë, duke i përzier mirë.- të aplikojë përzierjen në një copë pune.- të ushtrojë presion në nyje, duke hequr ngjitësin e tepërt.- të aplikojë kohën e duhur për tu tharë ngjitësi.- të kontrollojë që elementet janë ngjitur duke arritur

cilësinë e kërkuar.

- të verifikojë që operacionet janë kryer në përputhje me specifikimet e treguara në dokumentacionin teknik.
- të verifikojë funksionueshmëria përfundimtare e elementit të montuar.
- të llogaritë koston dhe çmimin e punimeve të zmontimit dhe montimit të elementeve të çmontueshëm të lidhur me materialet ngjitëse.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zmontimit dhe montimit të elementeve të çmontueshëm të lidhur me materialet ngjitëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen riparimin e pjesëve metalike të karrocërisë, me anë të ngjitjes së butë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocërisë.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet matëse dhe kontrolluese të duhura.
- të kontrollojë pjesëte dëmtuara të karrocërisë dhe të përcaktojë shkallën e dëmtimit.
- të zmontojë pjesët e detalit metalik të dëmtuar, të karrocërisë (nëse është e nevojshme).
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me ngjitje të butë të pjesës së dëmtuar.
- të përzgjedhë pajisjen (havinë) e duhur për ngjitjen e butë.
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e nevojshme për të kryer procesin e ngjitjes së butë.
- të parapërgatitë detalin e dëmtuar për ngjitje të butë.
- të vendosë detalin e dëmtuar në pajisjen shtrënguese (në bango).
- të përgatitë pajisjen (havinë) për ngjitjen e butë.
- të përgatitë materialin (kallajin ose plumbin) për ngjitjen e butë.
- të kryejë procesin e ngjitjes së butë të detalit metalik.
- të kryejë punimin përfundimtar të pjesës së ngjitur të detalit.
- të heqë detalin e riparuar nga pajisja shtrënguese.
- të kontrollojë ngjitjen e detalit metalik.
- të montojë detalin e riparuar në karrocëri.
- të llogaritë koston dhe çmimin e riparimit me anë të ngjitjes së butë.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit, gjatë riparimit të karrocerisë me anë të ngjitjes së butë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen riparimin e pjesëve metalike të karrocerisë me anë të ngjitjes së fortë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocerisë.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet matëse dhe kontrolluese të duhura.
- të kryejë kontrollin e pjesës së dëmtuar të karrocerisë dhe të përcaktojë shkallën e dëmtimit.
- të zmontojë pjesët (detalit) metalike të dëmtuara të karrocerisë (nëse është e nevojshme).
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me ngjitje të fortë të pjesës së dëmtuar.
- të përzgjedhë pajisjen e duhur për ngjitjen e fortë.
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e nevojshme për të kryer procesin e ngjitjes së fortë.
- të parapërgatitë detalin e dëmtuar për ngjitje të fortë.
- të vendosë detalin e dëmtuar në pajisjen shtrënguese (në bango).
- të përgatitë pajisjen për ngjitjen e fortë.
- të përgatitë materialin (bakrin, bronzin etj.) për ngjitjen e fortë.
- të kryejë procesin e ngjitjes së fortë të detalit metalik të karrocerisë.
- të kryejë punimin përfundimtar të pjesës së ngjitur të detalit.
- të kryejë heqjen e detalit të riparuar nga pajisja shtrënguese.
- të kryejë kontrollin e ngjitjes së detalit metalik.
- të kryejë montimin e detalit të riparuar në karroceri.
- të llogaritë koston dhe çmimin e riparimit me anë të ngjitjes së fortë.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të karrocerisë me anë të ngjitjes së fortë

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen riparimin e pjesëve të karrocerisë, me anë të ngjitjes me materiale ngjitëse.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocerisë.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe



kontrolluese.

- të bëjë kontrollin e pjesës së dëmtuar të karrocerisë dhe të përcaktojë llojin dhe shkallën e dëmtimit.
- të bëjë zmontimin e pjesës së dëmtuar të karrocerisë (nëse është e nevojshme).
- të përcaktojë mënyrën e duhur për riparimin me materiale ngjitëse të pjesës së dëmtuar.
- të përzgjedhë materialet ngjitëse dhe veglat e duhura për të kryer procesin e ngjitjes.
- të lexojë dhe interpretojë drejt udhëzimet për përgatitjen dhe përdorimin e materialeve ngjitëse.
- të bëjë parapërgatitjen mekanike dhe pastrimin e sipërfaqeve të pjesëve që do të ngjiten me materiale ngjitëse.
- të bëjë përgatitjen e materialit ngjitës.
- të bëjë lyerjen ose mbushjen me material ngjitës të sipërfaqeve të pjesëve që do të ngjiten.
- të bëjë bashkimin dhe fiksimin e pjesëve që do të ngjiten në pozicionin e duhur.
- të bëjë punimin përfundimtar të sipërfaqeve të ngjitura, pas ngurtësimit të materialit ngjitës.
- të bëjë kontrollin e ngjitjes së pjesës së dëmtuar të karrocerisë.
- të bëjë montimin (në rast se është zmontuar) të pjesës së riparuar me ngjitje, në karroceri.
- të llogaritë koston dhe çmimin e riparimit me anë të ngjitjes me materiale ngjitëse.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të pjesëve të karrocerisë me anë të ngjitjes me materiale ngjitëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen riparimin e pjesëve plastike të karrocerisë, me anë të saldimit plastik.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocerisë.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese.
- të kryejë kontrollin e pjesës plastike të dëmtuar të karrocerisë dhe përcaktimin e shkallës së dëmtimit.
- të kryejë zmontimin e pjesës plastike të dëmtuar të karrocerisë (nëse është e nevojshme).
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me saldim plastik të pjesës së dëmtuar të karrocerisë.
- të përzgjedhë pajisjen termike dhe materialin mbushës, të duhura për saldimin plastik.

- të përzgjedhë veglat e nevojshme për të kryer procesin e saldimit plastik.
- të kryejë parapërgatitjen mekanike dhe pastrimin e sipërfaqeve të pjesëve plastike ku do të kryhet saldimit plastik.
- të vendosë dhe fiksojë pjesët që do të saldohen në pozicionin e duhur.
- të përgatitë pajisjen termike dhe të vendosë parametrat e duhura për saldimit plastik.
- të kryejë saldimit plastik të pjesëve plastike të dëmtuara të karrocerisë.
- të kryejë punimin përfundimtar të tegelit të saldimit plastik.
- të kryejë kontrollin e saldimit plastik të pjesëve plastike të dëmtuara të karrocerisë.
- të kryejë montimin (në rast se ishte zmontuar) të pjesës së riparuar në karroceri.
- të kryejë llogaritjen e kostos dhe të çmimit të riparimit me anë të saldimit plastik.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të pjesëve plastike të karrocerisë me anë të saldimit plastik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shkollës ose në mjedise pune reale (servise) ku kryhen punime të riparimit me ngjitje të pjesëve metalike dhe plastike të karrocerive të mjeteve të transportit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të ngjitjeve të buta dhe të forta, të ngjitjeve me materiale ngjitëse dhe të saldimit plastik të pjesëve të karrocerive.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të parapërgatitjes dhe të realizimit të teknikave dhe procedurave të ngjitjeve të buta dhe të forta, të ngjitjeve me materiale ngjitëse dhe të saldimit plastik të pjesëve të karrocerive, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e teknikave të duhura të ngjitjes së pjesëve metalike dhe plastike të karrocerive.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme për
realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës për ngjitje të pjesëve të karrocërive.
- Aparate, pajisje dhe vegla për ngjitje të forta dhe të buta dhe për saldim plastik.
- Materialet e nevojshme për ngjitje të forta dhe të buta dhe për saldim plastik.
- Materiale ngjitëse të ndryshme dhe udhëzuesa të përdorimit të tyre
- Komplet i pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kontroll dhe matje të pjesëve të karrocërësë.
- Karrocëri të mjeteve të transportit dhe pjesë të ndryshme metalike dhe plastike, të karrocërive.
- Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
- Katalloge të mjeteve të transportit, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

7. Moduli: “Riparimi i shformimeve të pjesëve metalike të karrocerisë”

Drejtimi: Shërbime mjeteve transporti

Profili: Shërbime karrocerise

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	RIPARIMI I SHFORMIMEVE TË PJESËVE METALIKE TË KARROCERISË	(M-18-1930-23)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të diagnostikuar shkallën e deformimeve dhe riparuar elementët metalikë (çelik dhe alumin) të karrocerisë.	
Kohëzgjatja e modulit	34 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjeteve transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi diagnostikon shkallën e deformimeve në elementët metalikë të karrocerisë.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë dokumentacionin teknik të karrocerisë.- të identifikojë materialin metalik.- të përcaktojë karakteristikat dhe vetitë e elementit prej metalik- të përdorë teknikat diagnostikuese për shkallën e deformimeve në elementët metalikë.- të përcaktojë deformimin bazuar në shtrirjen e tij.- të përzgjedhë instrumentat e aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese.- të përcaktojë vendndodhjen e deformimit (qasje e lehtë, akses i vështirë dhe pa akses)- të përcaktojë shkallën dhe llojin e deformimit nga dëmtimi.- të përcaktojë në bazë të dëmtimit pjesët që zëvendësohen ose riparohen.- të verifikojë që diagnoza kufizon deformimin e krijuar.- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë diagnostikimit të shkallës së deformimit në elementët metalikë të karrocerisë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	



RN 2 Nxënësi riparon elementët e çelikut të karrocerisë, duke i kthyer format dhe dimensionet origjinale.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të karrocerisë
- të analizojë dokumentacionin teknik specifik të zonës që do të riparohet
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për riparimin e elementëve prej çeliku të karrocerisë.
- të zbatojë teknikat e përgatitjes për riparimin e elementeve prej çeliku.
- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet specifike për riparimin e elementeve të çelikut.
- të përcaktojë metoda e riparimit në bazë të llojit të dëmtimit.
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin.
- të përdorë nxehjen paraprake (nëse është e nevojshme).
- të përdorë trajtim me goditje ose tërheqje.
- të përdorë trajtim me goditje të mëdha.
- të zbatojë teknikat e verifikimit të konformitetit të elementeve, me anë të pajisjeve përkatëse.
- të zbatojë proceset e riparimit të elementeve në zona të aksesueshme.
- të zbatojë proceset e riparimit të elementeve në zona të pa aksesueshme.
- të përgatitë zonën për tërheqje duke e pastruar.
- të aplikojë tërheqjen e deformimit me mjetet përkatëse (thithëse, gozhdë të salduar, rondele, ndër të tjera)..
- të përgatitë zonës për mbushje (aplikim kallaji, stuko)..
- të aplikojë produktet mbushëse.
- të kontrollojë ecurinë riparimit të deformimit.
- të kontrollojë zonën ku kryhet riparimi.
- të kontrollojë gjendjen përfundimtare të riparimit.
- të kryjë llogaritjen e kostos dhe të çmimit të riparimit të elementëve prej çeliku të karrocerisë.
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të elementëve prej çeliku të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi riparon elementët e aluminit të karrocerisë, duke i kthyer format dhe dimensionet origjinale.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të karrocerisë
- të analizojë dokumentacionin teknik specifik të zonës që do të riparohet
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për riparimin e

- elementëve prej alumini të karrocerisë.
- të zbatojë teknikat e përgatitjes për riparimin e elementeve prej alumini.
 - të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet specifike për riparimin e elementeve të aluminit.
 - të përcaktojë metoda e riparimit në bazë të llojit të dëmtimit.
 - të përcaktojë hapat e duhura për riparimin.
 - të përcaktojë sjelljen e aluminit në riparim
 - të përdorë trajtim mekanik.
 - të përdorë trajtim termik.
 - të zbatojë teknikat e verifikimit të konformitetit të elementeve, me anë të pajisjeve përkatëse.
 - të zbatojë metodat e riparimit në sipërfaqet e alumini.
 - të zbatojë metodat e riparimit në panelet e aluminit.
 - të zbatojë proceset e riparimit të elementeve në zona të aksesueshme.
 - të zbatojë proceset e riparimit të një shformimi për shkak të thyerjes.
 - të zbatojë proceset e riparimit të elementeve në zona të pa aksesueshme.
 - të përgatitë zonën për tërheqje duke e pastruar.
 - të aplikojë tërheqjen e ~~de~~shformimit me mjetet përkatëse.
 - të përgatitë zonës për mbushje (aplikim kallaji, stuko)..
 - të aplikojë produktet mbushëse.
 - të kontrollojë ecurinë riparimit të ~~de~~shformimit.
 - të kontrollojë zonën ku kryhet riparimi.
 - të kontrollojë gjendjen përfundimtare të riparimit.
 - të kryejë llogaritjen e kostos dhe të çmimit të riparimit të elementëve prej alumini të karrocerisë.
 - të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të elementëve prej alumini të karrocerisë.
- Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të mjeteve të transportit ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të riparimit të shformimeve të elementëve metalikë të karrocerisë.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të riparimit të shformimeve të elementëve metalikë të karrocerisë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kontrollin, matjen dhe riparimin e shformimeve të elementëve metalikë të karrocerisë të mjeteve të transportit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i



shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për kontrollin, matjen dhe riparimin e shformimeve të elementëve metalikë të karrocërisë të mjeteve të transportit.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së riparimit të shformimeve të elementëve metalikë të karrocërisë të mjeteve të transportit (në shkollë ose në servise reale).
 - Automjet mësimor.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kontrollin, matjen dhe riparimin të shformimeve të elementëve metalikë të karrocërisë.
 - Automjete mësimore.
 - Pjesë të karrocërive të automjeteve (parakolpo, maskarino, parafango, dyer, mbulesa motori dhe bagazhi, shasi, ramë).
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

8. Moduli “Punime të lyerjes së pjesëve metalike të karrocerisë”

Drejtimi: Shërbime mjetesesh transporti
Profili: Shërbime karrocerie
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË LYERJES SË PJESËVE METALIKE TË KARROCERISË	(M-18-1029-20)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer proceset përgatitore për lyerjen e pjesëve metalike të karrocerive të mjeteve të transportit, si dhe për kryer lyerjen e këtyre pjesëve.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi kryen punimet paraprake për lyerjen e pjesëve metalike të karrocerisë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt katalogun e karrocerisë.- të përcaktojë pjesët e karrocerisë që do të lyhen.- të përcaktojë hapat e procesit teknologjik për të kryer lyerjen e pjesëve të karrocerisë.- të përcaktojë pjesët e karrocerisë që do të përpunohen paraprakisht mekanikisht.- të përzgjedhë instrumentat e duhura të kontrollit.- të kryejë matjet dhe kontrollet e nevojshme.- të përzgjedhë veglat e nevojshme për të bërë përpunimin mekanik paraprak të pjesëve që do të lyhen.- të kryejë punimet mekanike paraprake (sheshimin e sipërfaqeve të shtypura, limimin e buzëve, pastrimin me letër zmerilio).- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve paraprake për lyerjen e pjesëve metalike. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi kryen stukimin dhe përpunimin përfundimtar të sipërfaqeve metalike të karrocerisë, që do të lyhen. Kriteret e realizimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë :</p>	

- të analizojë gjëndjen e sipërfaqeve metalike pas përpunimit paraprak.
- të përzgjedh drejt instrumentat kontrollues.
- të përzgjedh drejt veglat dhe materialet e nevojshme që për stukimin dhe punimin mekanik përfundimtar.
- të kryejë saktë procesin e stukimit.
- të kryejë saktë zmerilimin përfundimtar.
- të kryejë saktë kontrollin e cilësisë së stukimit dhe punimit mekanik përfundimtar.
- të përzgjedhë vegla e pajisjet e duhura për pastrimin kimik.
- të përzgjedhë materialet dhe solucionet e duhura për pastrimin kimik.
- të përgatitë enën (vaskën) për pastrimin kimik.
- të përgatitë solucionin kimik për heqjen e oksideve nga sipërfaqja që do të lyhet.
- të kryejë zhytjen e pjesës së karrocerisë në enën për heqjen e oksideve.
- të përgatitë solucionin kimik për heqjen e yndyrnave nga sipërfaqja që do të lyhet.
- të kryejë zhytjen e pjesës së karrocerisë në enën për heqjen e yndyrnave (në rastin kur boja do të jetë e lëngëshme).
- të kryejë shplarjen e pjesës së karrocerisë nga mbeturinat e solucionit kimik.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë stukimit dhe punimit mekanik përfundimtar të sipërfaqeve që do të lyhen.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen procesin e lyerjes, pjekjes dhe luçidimit të sipërfaqeve metalike të riparuar të karrocerisë.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të kryejë analizën dhe kontrollin e sipërfaqeve metalike që do të lyhen.
- të përcaktojë mënyrën e duhur të lyerjes së sipërfaqeve metalike të karrocerisë (në dhoma të posaçme apo në vende të caktuara).
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për lyerje.
- të përzgjedhë nga katalogu ose të përgatitë bojën me ngrën e duhur për lyerje
- të përzgjedhë dhe përgatitë pajisjen për lyerjen.
- të kryejë lyerjen e sipërfaqeve metalike të karrocerisë.
- të përcaktojë regjimin e duhur të procesit të pjekjes.
- të përgatitë furrën për pjekjen.
- të kryejë procesin e pjekjes së sipërfaqeve metalike të lyera.
- të përzgjedhë veglat e duhura për luçidimin e sipërfaqes.
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për luçidim.
- të kryejë luçidimin e sipërfaqeve metalike të karrocerisë, të

lyera dhe të pjekura.

- të kryejë kontrollin përfundimtar të sipërfaqeve metalike të lyera, të pjekura dhe të luçiduara të karrocerisë.
- të llogaritë koston dhe çmimin e punës së kryer.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të lyerjes, pjekjes dhe luçidimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e lyerjes të shkollës ose në reparte të tjera të bizneseve lokale që e krijojnë këtë mundësi.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve paraprake dhe kryesore të procesit të lyerjes së pjesëve metalike të karrocerisë. Në mungesë të furrës për pjekjen e bojës, mund të kryhen proceset e tjera pa pjekjen ose të praktikohet pjekja në furra të bizneseve lokale për shërbime të karrocerisë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e punimeve paraprake mekanike, të stukimit, lyerjes, pjekjes dhe luçidimit të sipërfaqeve metalike të karrocerisë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me tërësinë e proceseve të lyerjes.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e tërësisë së proceseve të lyerjes.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës të përshtatshme për kryerjen e punimeve paraprake dhe të lyerjes së pjesëve metalike të karrocerisë.
 - Pjesë të ndryshme metalike të karrocerisë që mundësojnë realizimin e procesit teknologjik të lyerjes.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrolle dhe lyerje të pjesëve metalike të karrocerisë.
 - Materialet e nevojshme për të realizuar procesin e lyerjes (stuko, bojëra etj.).
 - Furrë pjekjeje (në pamundësi të furrës me përmasa reale, mund të përdoren dhe furra të vogla për pjekjen e detaleve me përmasa të vogla).
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katallogë (të karrocerisë dhe bojërave), manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

9. Moduli “Riparimi i aksesorëve në karrocëritë e mjeteve të transportit”

Drejtimi: Shërbime mjeteve transporti

Profili: Shërbime karrocërie

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	RIPARIMI I AKSESORËVE NË KARROCËRITË E MJETEVE TË TRANSPORTIT	(M-18-1030-20)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer riparimin e aksesorëve të ndryshëm të karrocërive të mjeteve të transportit	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK të drejtimit “Shërbime mjeteve transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi riparon mekanizmat e fshirësve të xhamave të mjeteve të transportit.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të mekanizmave të fshirësve të xhamave (të përparmë dhe të pasëm) të mjeteve të transportit.- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të mekanizmave të fshirësve të xhamave.- të kryejë kontrollin e funksionimit dhe përcaktimin e parregullive.- të zmontojë pjesët e mekanizmave të fshirësve të xhamave.- të kryejë kontrollin, matjen dhe përcaktimin e parregullive të pjesëve të mekanizmave të fshirësve të xhamave.- të përcaktojë hapat e duhura riparimin/zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të mekanizmave të fshirësve të xhamave.- të përzgjedhë pjesët e reja që do të zëvendësojnë pjesët e dëmtuara.- të kryejë riparimin e pjesëve që mund të riparohen, me metodat përkatëse të riparimit.- të kryejë montimin e pjesëve të mekanizmave të fshirësve të xhamave.- të kryejë kontrollin e funksionimit të mekanizmave të fshirësve të xhamave, të riparuar.- të kryejë llogaritjen e kostos dhe çmimit të punës për	

-
- riparimin e mekanizmave të fshirëseve të xhamave.
 - të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të riparimit të mekanizmave të fshirëseve të xhamave.
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi riparon bravat dhe dorezat e dyerve të mjeteve të transportit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të dyerve të mjeteve të transportit.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të bravës dhe dorezës së derës.
- të kryejë kontrollin e funksionimit dhe përcaktimin e parregullsive të bravës dhe dorezës.
- të bëjë zmontimin e pjesëve që pengojnë heqjen e panelit të brendshëm të derës.
- të kryejë zmontimin dhe heqjen e panelit të brendshëm të derës
- të kryejë zmontimin e pjesëve të dorezës së derës dhe të bravës së derës
- të kryejë kontrollin, matjen dhe përcaktimin e parregullsive të pjesëve të bravës dhe dorezës së derës.
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin/zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të bravës dhe dorezës së derës.
- të përzgjedhë pjesët e reja që do të zëvendësojnë pjesët e dëmtuara.
- të riparojë pjesët që mund të riparohen, me metodat përkatëse të riparimit.
- të kryejë montimin e pjesëve të bravës së derës dhe të dorezës së derës.
- të kryejë montimin e panelit të brendshëm të derës
- të kryejë montimin e pjesëve të tjera të panelit të brendshëm të derës.
- të kryejë kontrollin e funksionimit të bravës dhe dorezës së derës, të riparuar.
- të kryejë llogaritjen e kostos dhe çmimit të punës për riparimin e bravës dhe dorezës së derës.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të riparimit të bravave dhe dorezave të dyerve

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi riparon mekanizmin e komandimit të xhamave të dyerve të mjeteve të transportit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të dyerve të mjeteve të transportit.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të mekanizmit të komandimit të xhamit të derës.
- të kontrollojë funksionimin dhe të përcaktojë parregullsitë e mekanizmit të komandimit të xhamit.
- të bëjë zmontimin e pjesëve që pengojnë heqjen e panelit të brendshëm të derës.
- të kryejë zmontimin dhe heqjen e panelit të brendshëm të derës
- të ulë xhamin në pozicion të përshtatshëm dhe të zmontojë mbajtësen e xhamit me rrëshqitësin e mekanizmit.
- të kryejë zmontimin e mbajtëseve dhe të mekanizmit të komandimit të xhamit të derës.
- të kryejë zmontimin e pjesëve të mekanizmit të komandimit të xhamit.
- të kryejë kontrollin, matjen dhe përcaktimin e parregullsive të pjesëve të mekanizmit të komandimit të xhamit.
- të përcaktojë hapat për riparimin/zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të mekanizmit të komandimit të xhamave.
- të përzgjedhë pjesët e reja që do të zëvendësojnë pjesët e dëmtuara.
- të riparojë pjesët që mund të riparohen, me metodat përkatëse të riparimit.
- të kryejë montimin e pjesëve të mekanizmit të riparuar të komandimit të xhamave.
- të kryejë montimin e mbajtëseve dhe të mekanizmit të komandimit të xhamit të derës.
- të kryejë montimin e mbajtëses së xhamit me rrëshqitësin dhe me xhamin.
- të kryejë montimin e panelit të brendshëm të derës.
- të kryejë montimin e pjesëve të tjera të panelit të brendshëm të derës.
- të kryejë kontrollin e funksionimit të mekanizmit të riparuar të komandimit të xhamit.
- të kryejë llogaritjen e kostos dhe çmimit të punës për riparimin e mekanizmit të komandimit të xhamit të derës.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të riparimit të mekanizmave të komandimit të xhamave të dyerve të mjeteve të transportit



Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi riparon mekanizmin e pasqyrave anësore të mjeteve të transportit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të pasqyrave të mjeteve të transportit.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të mekanizmit të pasqyrave anësore.
- të kryejë kontrollin e funksionimit dhe përcaktimin e parregullsive të funksionimit të mekanizmit të pasqyrës anësore.
- të kryejë zmontimin dhe heqjen e panelit të plotë të pasqyrës anësore (në rastin e dëmtimit të plotë).
- të kryejë montimin e panelit të ri të pasqyrës anësore.
- të kryejë zmontimin e kapakëve të panelit të pasqyrës anësore.
- të kryejë kontrollin dhe përcaktimin e parregullsive në pjesët e brendshme të mekanizmit të pasqyrës anësore.
- të përzgjedhë pjesët e reja që do të zëvendësojnë pjesët e dëmtuara.
- të zëvendësojë pasqyrën e dëmtuar.
- të zëvendësojë pjesët e dëmtuara të mekanizmit (elektrik ose mekanik) për kapjen dhe lëvizjen e pasqyrës anësore.
- të zëvendësojë pjesët e dëmtuara të mekanizmit mekanik të komandimit të pasqyrës anësore.
- të zëvendësojë kapakët e dëmtuar të panelit të pasqyrës anësore.
- të kryejë kontrollin e funksionimit të mekanizmit pasqyrës anësore të zëvendësuar ose të riparuar.
- të llogarisë koston dhe çmimin e punës për riparimin e mekanizmit të pasqyrës anësore.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të riparimit të mekanizmave të pasqyrave anësore të mjeteve të transportit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të karrocive të mjeteve të transportit ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të riparimit të aksesorëve kryesorë të karrocive të mjeteve të transportit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të kontrollit dhe riparimit të aksesorëve të karrocive të mjeteve të

transportit.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të kontrollit dhe riparimit të aksesorëve të karrocereve të mjeteve të transportit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për riparimin e aksesorëve të karrocereve të mjeteve të transportit .
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës për riparimin e aksesorëve të karrocereve të mjeteve të transportit (reparte të shkollës ose servise reale).
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matjen, kontrollin dhe riparimin e aksesorëve të karrocereve të mjeteve të transportit.
 - Automjet mësimor.
 - Pjesë këmbimi të aksesorëve të karrocereve të mjeteve të transportit.
 - Mekanizma të fshirjes së xhamave, brava dhe doreza të dyerve, mekanizma të komandimit të xhamave, mekanizma të pasqyrave
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Punime të lyerjes së pjesëve plastike të karrocerisë”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti
Profili: Shërbime karrocerie
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË LYERJES SË PJESËVE PLASTIKE TË KARROCERISË	(M-18-1032-20)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime përgatitore për lyerjen e pjesëve plastike të karrocereve të mjeteve të transportit, si dhe për të kryer lyerjen e këtyre pjesëve.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi kryen punimet paraprake për lyerjen e pjesëve plastike të karrocerisë.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt katallogun e karrocerisë.- të përcaktojë pjesët plastike e karrocerisë që do të lyhen.- të përzgjedhë instrumentat e duhura të kontrollit.- të kryejë matjet dhe kontrollet e nevojshme.- të përcaktojë llojin e materialit plastik.- të përcaktojë hapat e procesit teknologjik për të kryer lyerjen e pjesëve plastike të karrocerisë.- të përcaktojë pjesët plastike të karrocerisë që do të përpunohen paraprakisht mekanikisht.- të përzgjedhë veglat e nevojshme për të bërë përpunimin mekanik paraprak të pjesëve që do të lyhen.- të kryejë punimet mekanike paraprake (larjen me solvent, tamponimin e gropëzave, pastrimin me letër zmerilio).- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve paraprake për lyerjen e pjesëve plastike të karrocerisë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi kryen lyerjen fillestare dhe stukimin e sipërfaqeve të pjesëve plastike të karrocerisë.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë gjëndjen e sipërfaqeve plastike pas përpunimit paraprak.
- të përzgjedhë drejt instrumentat kontrollues.
- të përzgjedhë veglat dhe materialet e duhura për lyerjen fillestare, stukimin dhe punimin mekanik përfundimtar.
- të kryejë saktë procesin e lyerjes fillestare.
- të kryejë saktë procesin e stukimit.
- të kryejë saktë zmerilimin përfundimtar.
- të kryejë saktë kontrollin e cilësisë së lyerjes fillestare, stukimit dhe procesit të zmerilimit.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë lyerjes fillestare, stukimit dhe zmerilimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi kryen procesin e lyerjes dhe pjekjes (tharjes) së sipërfaqes plastike të riparuar të karrocerisë.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të bëjë analizën dhe kontrollin e sipërfaqeve plastike që do të lyhen.
- të përcaktojë mënyrën e duhur të lyerjes së sipërfaqeve plastike të karrocerisë (në dhoma të posaçme apo në vende të caktuara).
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për lyerje.
- të përzgjedhë nga katalogu ose të përgatitë bojën me ngryrën e duhur për lyerje
- të përzgjedhë dhe përgatitë pajisjen për lyerjen e pjesëve plastike të karrocerisë.
- të kryejë lyerjen e sipërfaqeve plastike të karrocerisë.
- të përcaktojë regjimin e duhur të procesit të pjekjes (tharjes).
- të përgatitë furrën për pjekjen (tharjen).
- të kryejë procesin e pjekjes (tharjes) së sipërfaqeve plastike të lyera.
- të bëjë kontrollin përfundimtar të sipërfaqeve plastike të lyera dhe të pjekura (thara) të karrocerisë.
- të llogaritë koston dhe çmimin e punës së kryer.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të lyerjes dhe pjekjes (tharjes) së pjesëve plastike të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e lyerjes së karrocerive në shkollë ose në reparte të lyerjes të bizneseve lokale që e krijojnë këtë mundësi.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve paraprake dhe kryesore të procesit të lyerjes së pjesëve plastike të karrocerisë. Në mungesë të furrës për pjekjen (tharjen) e bojës, mund të kryhen proceset e tjera ose të praktikohet pjekja (tharja) në furra të bizneseve lokale për shërbime të karrocerisë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e punimeve paraprake mekanike, të stukimit, lyerjes dhe pjekjes (tharjes) së sipërfaqeve plastike të karrocerisë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me tërësinë e proceseve të lyerjes.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e tërësisë së proceseve të lyerjes së pjesëve plastike të karrocerisë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës të përshtatshme për kryerjen e punimeve paraprake dhe të lyerjes së pjesëve plastike të karrocerisë.
 - Pjesë të ndryshme plastike të karrocerisë që mundësojnë realizimin e procesit teknologjik të lyerjes.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrollë dhe lyerje të pjesëve plastike të karrocerisë.
 - Materialet e nevojshme për të realizuar procesin e lyerjes (stuko, bojëra etj.).
 - Furrë për pjekje ose tharje (në pamundësi të furrës me përmasa reale, mund të përdoren dhe furra të vogla për tharjen e detaleve me përmasa të vogla).
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katallogë (të karrocerisë dhe bojërave), manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Zëvendësimi i xhamave të mjeteve të transportit”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Profili: Shërbime karrocierie

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ZËVENDËSIMI I XHAMAVE TË MJETEVE TË TRANSPORTIT	(M-18-1033-20)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer zëvendësimin e xhamave të palëvizshëm dhe të lëvizshëm të mjeteve të transportit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zëvendëson xhamat e përparmë të mjeteve të transportit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të mjetit të transportit.- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të xhamave.- të bëjë kontrollin e xhamit të përparmë (të palëvizshëm) dhe të përcaktojë parregullsitë.- të përzgjedhë xhamin e përparmë dhe gominën të duhura për zëvendësim.- të përzgjedhë materialin e duhur ngjitës.- të bëjë pastrimin e xhamit të përzgjedhur.- të bëjë heqjen e krahëve të fshirëseve të xhamit dhe mbrojtësen plastike.- të bëjë prerjen dhe heqjen pjesës së jashtme të gominës së xhamit.- të bëjë prerjen, me pajisje prerëse me tel, të lidhjes së gominës me xhamin, në të gjithë perimetrin përkatës.- të bëjë heqjen e xhamit nga gomina e mbetur në kornizë.- të bëjë heqjen e pjesës së mbetur të gominës nga korniza e xhamit.- të bëjë pastrimin e kornizës së xhamit nga mbetjet e gominës dhe të ngjitësit.- të bëjë vendosjen e gominës së re në xhamin e ri.- të bëjë pastrimin me solucion të gominës, të xhamit dhe të kornizës së xhamit.- të bëjë lyerjen me material e duhur ngjitës (silikon) të	

-
- gominës dhe të pjesës së xhamit pa gominë.
 - të bëjë vendosjen e xhamit në pozicionin e duhur në kornizë.
 - të bëjë fiksimin paraprak të xhamit me shirita ngjitës.
 - të vendosë mbrojtësen plastike dhe të montojë krahët e fshirëseve të xhamit.
 - të vendosë pasqyrën në xhamin e përparmë.
 - të heqë shiritat ngjitës.
 - të bëjë kontrollin përfundimtar të montimit të xhamit të përparmë.
 - të bëjë llogaritjen e kostos dhe të çmimit të punës për zëvendësimin e xhamit të përparmë të mjetit të transportit.
 - të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të xhamit të përparmë të mjetit të transportit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi zëvendëson xhamat e pasëm dhe anësorë, të palëvizshëm, të mjeteve të transportit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocërisë së mjetit të transportit.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të xhamave.
- të bëjë kontrollin e xhamave të pasëm dhe anësorë, të palëvizshëm, si dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të përzgjedhë xhamin, së bashku me gominën përkatëse, të duhura për zëvendësim.
- të bëjë pastrimin e xhamit të përzgjedhur.
- të shkëputë lidhje elektrike (nëse ka) nga xhami i dëmtuar.
- të bëjë lirim të vidave shtrënguese të fashetave mbajtëse të xhamit të dëmtuar.
- të bëjë heqjen e xhamit të dëmtuar.
- të bëjë pastrimin e kornizës së xhamit nga mbetjet e xhamit të dëmtuar.
- të bëjë vendosjen e xhamit të ri (së bashku me gominën) në kornizën përkatëse.
- të bëjë shtërngimin e vidave të fashetave mbajtëse të xhamit.
- të rivendosë lidhjet elektrike (nëse ka) në xhamin e montuar.
- të bëjë kontrollin përfundimtar të montimit të xhamit të pasëm ose anësor, të palëvizshëm.
- të logaritë koston dhe çmimin e punës për zëvendësimin e xhamave të pasëm dhe anësorë, të palëvizshëm.
- të bëjë plotësimin e dokumentacionit teknik dhe financiar për punën e kryer.

- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të xhamave të pasëm dhe anësorë, të palëvizshëm, të mjetit të transportit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi zëvendëson xhamat e lëvizshëm të dyerve të mjeteve të transportit.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocërisë së mjetit të transportit.
- të përzgjedhë instrumentet dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të xhamave.
- të bëjë kontrollin e xhamave të lëvizshëm të dyerve dhe përcaktimin e parregullsisë.
- të bëjë zmontimin e pjesëve që pengojnë heqjen e panelit të brendshëm të derës.
- të bëjë zmontimin dhe heqjen e panelit të brendshëm të derës
- të bëjë pastrimin nga pjesët e xhamave (nëse xhami është thyer).
- të ulë në pozicion të përshtatshëm mbajtësen e xhamit dhe të heqë pjesët e mbetura të xhamit nga mbajtësja.
- të bëjë heqjen e gominës së poshtme të dritares për të lehtësuar futjen e xhamit të ri.
- të përzgjedhë xhamin e duhur për zëvendësim.
- të bëjë pastrimin e xhamit të përzgjedhur.
- të bëjë futjen e xhamit të ri në gominat e dritares së derës.
- të bëjë montimin e xhamit të ri në mbajtësen përkatëse.
- të bëjë provën paraprake të rrëshqitjes së xhamit të montuar në mbajtëse.
- të bëjë montimin e panelit të brendshëm të derës.
- të vendosë gominën e poshtme të dritares.
- të bëjë montimin e pjesëve të tjera të hequra nga paneli i brendshëm i derës.
- të bëjë kontrollin e funksionimit të xhamit të lëvizshëm të zëvendësuar të derës.
- të bëjë llogaritjen e kostos dhe të çmimit të punës për zëvendësimin e xhamit të lëvizshëm.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të xhamave të lëvizshëm të dyerve të mjeteve të transportit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të karrocive të mjeteve të transportit ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të zëvendësimit të xhamave të mjeteve të transportit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të zëvendësimit të xhamave të mjeteve të transportit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të kontrollit dhe zëvendësimit të xhamave të ndryshëm të mjeteve të transportit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për zëvendësimin e xhamave të ndryshëm të mjeteve të transportit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës për zëvendësimin e xhamave të mjeteve të transportit (reparte të shkollës ose servise reale).
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kontrollin dhe zëvendësimin e xhamave të mjeteve të transportit.
 - Automjete mësimore.
 - Xhama të ndryshëm (të përparmë, të pasëm, anësorë, të lëvizshëm) të mjeteve të transportit.
 - Gomina të xhamave të mjeteve të transportit.
 - Ngjitësa të xhamave dhe gominave.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Riparimi i strukturës së mjetit me pajisje shtrënguese”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Profili: Shërbime karrocierie

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	RIPARIMI I STRUKTURËS SË MJETIT ME PAJISJE SHTRËNGUESE	(M-18-1931-23)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të riparuar me tërheqje në pjesë të ndryshme të shformuara të strukturës së automjetit, në bankon e punës për shërbime karrocierie, me mjete shtrënguese	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përcakton llojin e deformimit në strukturën e mjetit dhe kryen punime përgatitore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt dokumentacionin teknik përkatës- të përcaktojë parametrat që duhet të kontrollohen në strukturën e mjetit;- të pëzgjedhë pajisjet e diagnostikimit, instrumentat e aparatet e duhura matëse të dëmtimeve, duke i lidhur ato me deformimet që duhen kontrolluar;- të kryejë kontrole dhe matje të sakta për përcaktimin e shkallës së deformimit;- të përcaktojë zonat e deformatuara janë përcaktuar në mënyrë tredimensionale;- të zmontojë elementët e nevojshëm të mjetit përpara vendosjes së tij në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje;- të pëzgjedhë mjetet për pozicionimin dhe qëndrimin e mjetit;- të përcaktojë saktë pikat e fiksimit dhe kontrollit në bazë të deformimeve dhe riparimeve që duhen kryer;- të pastrojë zonat e fiksimit dhe nofullat shtrënguese;- të pozicionojë mjetin në bankon punuese sipas specifikimeve teknike;- të lidh pjesët e deformatuara në strukturë në pikat e tërheqjes të përcaktuara;- të përcaktojë drejtimitet e sakta të tërheqjes dhe pikat e aplikimit të stresit;	

- të përcaktojë pikat e aplikimit të goditjeve dhe kundërgoditjeve, duke marrë parasysh konformimin e strukturës që duhet të arrihet;
- të identifikojë pjesët e strukturës së mjetit që duhen riparuar ose zëvendësuar;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të strukturës së mjetit në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi riparon strukturën e mjetit me pajisje dhe mjete shtrënguese.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë teknikat dhe procedurat e kërkuara në çdo rast..
- të vendosë mjetet e nevojshme të sigurisë;
- të kontrollojë që gjuajtjet dhe kundërgoditjet janë bërë në strukturë derisa matjet reale të përputhen me ato të parashikuara në fletët e kontrollit të prodhuesit;
- të kontrollojë forcën tërheqë në mënyrë që të mos prodhojë deformime të tjera;
- të kontrollojë që tensionet në fletë janë hequr në fund të çdo faze të tërheqjes;
- të riparojë ose zëvendësojë pjesët e strukturës së mjetit që duhen riparuar ose zëvendësuar;
- të kryejë matje dhe kontrole duke përdorur pajisje matëse;
- të verifikojë që elementët e strukturës kanë marrë përmasat e tyre origjinale pas riparimit;
- të verifikojë që pas riparimit, zonat e përcaktuara ruajnë pikat e siguresave të deformimit;
- të verifikojë që riparimi është kryer sipas specifikimeve teknike.;
- të tregojë kujdes të veçantë për inspektimin e zonave të riparuar;
- të kontrollojë që pajisjet matëse dhe testuese janë trajtuar me kujdesin e duhur për të shmangur dëmtimet;
- të bëjë llogaritjen e kostos dhe të çmimit të riparimit të strukturës së mjetit në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje;
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të strukturës së mjetit në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të mjeteve të transportit ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të riparimit të strukturës së mjetit në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të riparimit të strukturës së mjetit në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kontrollin, matjen dhe riparimin riparimit të strukturës së mjetit në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për kontrollin, matjen dhe riparimin riparimit të strukturës së mjetit në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së riparimit riparimit të strukturës së mjetit në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje (në shkollë ose në servise reale).
 - Banko e punës për shërbime karrocierie me tërheqje
 - Automjet mësimor.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kontrollin, matjen dhe riparimin riparimit të strukturës së mjetit në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje.
 - Automjete mësimore.
 - Struktura dhe pjesë të ndryshme të tyre.
 - Karroceri, kabina të ndryshme të mjeteve të transportit dhe pjesë të ndryshme të tyre.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Diagnostikimi elektronik në elementët strukturore të mjetit”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Profili: Shërbime karrocierie

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DIAGNOSTIKIMI ELEKTRONIK NË ELEMENTËT STRUKTURORE TË MJETIT	(M-18-1932-23)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të diagnostikimit elektronik të trupit të automjetit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar Nivelin II të KSHK, të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi parapërgatit diagnostikimin elektronik në elementët strukturore të mjetit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të analizojë dokumentacionit teknik të strukturës të mjetit.- të vendosë automjetin në postin e punës në bankon e punës për shërbime karrocierie me tërheqje .- të vendosë pajisjen diagnostikuese në suportin mbajtës.- të përgatisë pajisjen diagnostikuese dhe montimin e aksesoreve të nevojshëm për diagnostikim.- të vendosë pajisjes diagnostikuese në suportin mbajtës.- të zbatojë rekomandimet e prodhuesit të pajisjeve për ta lidhur sistemin me kompjuterin në stacionin e punës.- të zbatojë instruksionin e të dhënave për diagnostikimin (Programi i softuerit diagnostikues).- të realizojë futjen e të dhënave të caktuara administrative në lidhje me punën që duhet të kryhet (klienti, automjeti, kompania e sigurimeve, riparuesi)- të zgjedhë nga prodhuesi i automjetit në bazën e të dhënave, modelin dhe versionin e strukturës.- të analizojë skemën e trupit të autotomjetit, me specifikimet e pikave që duhet të verifikohen, si dhe elementët e kontrollit të kërkuar për secilën prej tyre.- të lidhë printerin me kompjuterin.- të përzgjedhë pikat zero të përqendrimit, të cilat do të shërbejnë për krijimin e planeve referuese nga të cilat do të verifikohet çdo pikë e strukturës- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së	

mjedisit gjatë parapërgatitjes për diagnostikimin elektronik në elementët strukturore të mjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen diagnostikimin elektronik të trupit të automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë diagnostikimin elektronik të në elementët strukturore të mjetit.
- të përqendrojë paisjen diagnostikuese elektronike në pikat e përcaktuara.
- të printojë skemën e të dhënave të prodhuesit.
- të realizojë matjet në elementët strukturore të mjetit .
- të realizojë teknikat e matjes me paisjen diagnostikuese elektronike në trupin e automjetit.
- të zbatojë teknikat e ndryshme për matjen e elementëve strukturore të mjetit.
- të realizojë matje krahasuese në lidhje me fletën e të dhënave të prodhuesit.
- të realizojë matje krahasuese simetrike midis pikave të ndryshme të trupit të automjetit.
- të realizojë matje krahasuese diagonale midis pikave të ndryshme të trupit të automjetit.
- të realizojë matje krahasuese gjatësore midis pikave të ndryshme të trupit të automjetit.
- të vlerësojë gjendjen e nyjeve të ndryshme metalike në elementët strukturore të mjetit .
- të realizojë kontrollin e këndeve të gjeometrisë së sistemit të drejtimit.
- të llogaritë koston dhe çmimin e diagnostikimin elektronik në elementët strukturore të mjetit .
- të përgatitë dokumentacionin teknik dhe financiar të punës së kryer.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë diagnostikimit elektronik të elementëve strukturore të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në reparte ose në mjedise pune (servise) ku kryhet diagnostikimi elektronik në elementët strukturore të mjetit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të diagnostikimit elektronik në elementët strukturore të mjetit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e diagnostikimit elektronik në elementët strukturore të

mjetit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e diagnostikimit elektronik në elementët strukture të mjetit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës në shkollë ose në servise.
 - Aparate për diagnostikimin elektronik të në elementët strukture të mjetit.
 - Materialet e nevojshme për diagnostikimin elektronik në elementët strukture të mjetit .
 - Banko e punës për shërbime karrocerie me tërheqje
 - Automjet mësimor.
 - Struktura dhe pjesë të ndryshme të tyre.
 - Karrocieri, kabina të ndryshme të mjeteve të transportit dhe pjesë të ndryshme të tyre.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katalloge të mjeteve të transportit, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Siguria në punën me automjetet hibride dhe elektrike”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Profili: Shërbime karrocerie

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	SIGURIA NË PUNËN ME AUTOMJETET HIBRIDE DHE ELEKTRIKE	M-18-1581-20
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer shkëputjen e tensionit të lartë nga sistemi elektrik i automjetit dhe për të zbatuar masat e sigurisë gjatë kryerjes së punimeve në automjetet hibride dhe elektrike.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh transporti”.	
Rezultatet e të nxënësve (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e automjeteve hibride dhe elektrike Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përshkruajë automjetet elektrike, llojet, veçoritë, përparësitë dhe kufizimet e tyre.– të analizojë skemat, pjesët përbërëse dhe funksionimin e automjeteve elektrike.– të përshkruajë rrjetin elektrik të automjeteve elektrike.– të tregojë transmetimin e lëvizjes të llojet e ndryshme të automjeteve elektrike.– të përshkruajë automjetet hibride, llojet, veçoritë, përparësitë dhe kufizimet.– të analizojë skemat, pjesët përbërëse dhe funksionimin e automjeteve hibride.– të përshkruajë rrjetin elektrik të automjeteve hibride.– të përshkruajë krijimin dhe transmetimin e lëvizjes të automjetet hibrid seri.– të përshkruajë krijimin dhe transmetimin e lëvizjes të automjetet hibrid paralel.– të përshkruajë krijimin dhe transmetimin e lëvizjes të automjetet hibrid seri-paralel.– të përshkruajë bateritë e tensionit të lartë dhe sistemin e ftohjes së tyre.– të përshkruajë motorët elektrikë, llojet, veçoritë e tyre në automjetet elektrike dhe hibride.– të përshkruajë konvertitorin (shndërruesin) statik (tip radrizator,

-
- inverter), llojet, veçoritë.
 - të përshkruajë karikuesin, llojet, veçoritë.
 - të përshkruajë njësinë e kontrollit *ECU* në automjetet elektrike dhe hibride.
 - të tregojë si kryhet frenimi me rigjenerim dhe rikuperimi i energjisë elektrike.
 - të përshkruajë sistemet ndihmëse elektrike në automjetet elektrike dhe hibride.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe me shkrim

RN 2 Nxënësi përshkruan dhe zbaton rregullat e sigurisë në punën me automjetet hibride dhe elektrike

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën e punës dhe të sigurojë pajisjet mbrojtëse gjatë punës me automjetet hibride dhe elektrike.
- të përshkruajë efektet e rrymës elektrike në trupin e njeriut.
- të tregojë çfarë është goditja elektrike dhe pasojat e saj.
- të tregojë veprimet për ndihmën e shpejtë në rastet e goditjes nga rryma elektrike.
- të përshkruajë rreziqet nga rryma elektrike gjatë punës me automjetet hibride dhe elektrike.
- të shpjegojë pasojat e gabimeve të mundëshme që shfaqen gjatë punës me automjetet hibride dhe elektrike.
- të identifikojë pikat me rrezikshmëri të lartë në automjetet hibride dhe elektrike.
- të zbatojë rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisje nën tension të lartë në automjete.
- të zbatojë masat mbrojtëse ndaj goditjes nga rryma elektrike.
- të zbatojë masat mbrojtëse ndaj shkarkesave elektrike.
- të zbatojë masat mbrojtëse ndaj zjarrit për shkak të rrymës elektrike.
- të zbatojë masat për mënjanimin e dëmtimeve të automjetit dhe pajisjeve nga rryma elektrike.
- të zbatojë masat mbrojtëse gjatë furnizimit me energjie elektrike të automjeteve elektrike.
- të zbatojë masat mbrojtëse gjatë kryerjes së matjeve elektrike dhe kontrolleve në automjetet hibride dhe elektrike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje përgjigje me gojë

RN 3 Nxënësi kryen procedurat e shkëputjes së tensionit të lartë në automjetet hibride dhe elektrike***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të kryejë regjistrimin e automjetit hibrid ose elektrik me defekte teknike dhe të hapë urdhërin e punës.
- të konsultohet me dokumentacionin teknik të automjetit hibrid ose elektrik.
- të bëjë identifikimin e tipit të automjetit hibrid ose elektrik.
- të veshë uniformën e punës dhe të përdorë mjetet mbrojtëse.
- të bëjë përgatitjen e vendit dhe mjeteve të punës.
- të aktivizojë frenat e dorës dhe të vendosë takot ndaluese në rrotat e automjetit.
- të vendosë shenjën dalluese të automjetit hibrid ose elektrik.
- të bëjë bllokimin e zonës përreth automjetit për të mos lejuar hyrjen e personave të paautorizuar
- të heqë çelësin e automjetit hibrid ose elektrik dhe të bëjë sigurimn e tij në vendin e caktuar.
- të bëjë shkëputjen e kabllit nga poli (-) i baterisë 12V dhe izolimin e tij.
- të përcaktojë vendndodhjen e çelësit të shkëputjes së tensionit të lartë.
- të heqë prizën e tensionit të lartë dhe sigurimin e saj në vend të sigurtë.
- të ndërpresë punimet për rreth 15 minuta që të shkarkohen kondensatorët nga energjia e akumuluar.
- të bëjë kontrollin e instrumentit matës në baterinë 12V.
- të bëjë matjen e tensionit të lartë me instrumentin matës, nëpërmjet lidhjes nga poli (+) në shasi dhe nga poli (-) në shasi, për të verifikuar shkëputjen e plotë të tensionit.
- të bëjë rikontrollin e instrumentit në baterinë 12V
- të vendosë tabelën që tregon shkëputjen e tensionit të lartë në automjetin hibrid ose elektrik.
- të kryejë punimet e tjera të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjetit hibrid ose elektrik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore, në repartin e shkollës për shërbime të automjeteve hibride dhe elektrike, ose në servise ku kryhen këto shërbime.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të zbatimit të masave të sigurisë dhe të procedurave të shkëputjes së tensionit të lartë në automjetet hibride dhe elektrike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari praktike për zbatimin e masave të sigurisë dhe të procedurave të shkëputjes së tensionit të lartë në automjetet hibride dhe elektrike, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur, dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata

duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë praktike që kryejnë.

- Mesuesi i praktikës duhet të përdorë metodën e simulimit të parregullsive në automjetet hibride dhe elektrike, si dhe të garantojë masat e sigurisë në punë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që përmban moduli.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore me mjete didaktike
 - Repart pune për shërbime në automjetet hibride ose elektrike
 - Automjete hibride ose elektrike
 - Maket automjetesh hibride ose elektrike.
 - Pajisje lexuese (scan tool).
 - Mjete mbrojtëse
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrolle në automjetet hibride ose elektrike.
 - Katalogë, *LUCAS NULLE LabSoft*, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-